



## KUVENDI I KOMUNËS – VUSHTRRI

---

KOMUNA E VUSHTRRIË - KOSOVË  
MUNICIPALITY OF VUSHTRRI - KOSOVA  
OPŠTINA VUČITRIŃ - KOSOVO

01 No: 499/04 Dt: 16.07.2004  
VUSHTRRI

RREGULLORE  
MBI SIGURIMIN E KOMUNIKACIONIT NË TERITORIN E KOMUNËS SË  
VUSHTRRIË

KORRIK - 2004



Në bazë të nenit 2. al.2 dhe nenit 4 të Rregullores, nr.2000/45 mbi Vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, nenit 159 dhe 160, të Ligjit mbi Sigurimin e Komunikacionit në Rrugë, (Gazeta Zyrtare e Kosovës nr.5/84), nenit 5 pika 2, nenit 6 dhe 20, të Ligjit për Rrugët, nr.2003/11, të Rregullores, nr.1999/24 mbi Ligjin e aplikueshëm në Kosovë, dhe nenit 5,27 dhe 88 të Statutit të Komunës. Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 16.07.2004, miratoi këtë:

## **R R E G U L L O R E**

### **Mbi sigurimin e komunikacionit në teritorin e Komunës së Vushtrrisë**

#### **I. DISPOZITAT E PËRGGJITHSHME**

##### **Neni 1.**

Me këtë Rregullore rregullohen qështjet lidhur me sigurimin e komunikacionit në rrugët lokale dhe rrugët në vendbanime si dhe në vet qytetin e Vushtrrisë në pikëpamje të caktimit të masave të kufizimit, ndaljes dhe të parkimit të automjeteve dhe mjeteve tjera motorrike si dhe masave tjera të nevojshme lidhur me këtë:

#### **II. KOMUNIKACIONI**

##### **Neni 2.**

##### **1. Shpejtësia e lëvizjes së automjeteve**

Në teritorin e qytetit dhe në vendet tjera të banuara të komunës, automjetet nuk mund të lëvizin me shpejtësi më të madhe se 40 km/orë.

Organi komunal kompetent për punët e komunikacionit – Drejtoria për Shërbime Publike (në tekstin e mëtejme: DSHP) kur është e nevojshme, mund të kufizoj shpejtësinë e lëvizjes edhe nën shpejtësin e përcaktuar nga paragrafi 1. i këtij neni.

##### **2. Përparsia e kalimit**

##### **Neni 3.**

DSHP me vendim të posaçëm dhe me shenja përkatëse të komunikacionit do t'i caktoj rrugët me përparsi të kalimit.

### **3. Kufizimi i komunikacionit**

#### **Neni 4.**

Në disa rrugë ose në pjesët e rrugëve, komunikacioni mund të kufizohet plotësisht ose pjesërisht me vendim përkatës të DSHP, ose me shenja të komunikacionit me qëllim të mbrojtjes së pjesëmarrësve në komunikacion, arritjes së sigurisë më të madhe të komunikacionit dhe të zhvillimit të komunikacionit pa pengesa si dhe me qëllim të kryerjes së punëve në këto rrugë.

Në disa rrugë, kur ate e kërkon interesi i sigurisë publike, komunikacioni mund të kufizohet përkatësisht.

#### **Neni 5.**

Si zonë e mbrojtur dhe e rezervuar për këmbësorë, caktohen të gjitha trotuaret në qytet të cilët në çdo kohë duhet të jenë të lirë. Kurse rruga “Dëshmort e Kombit”, prej fillimit e deri te kryqzimi me rrugën “Vllëzrit Gërvalla”, prej ores 19<sup>00</sup> gjerë në ora 23<sup>00</sup> caktohet rrugë e rezervuar për këmbësorë. Në këtë kohë ndalohet qarkullimi i automjeteve, përveq atyre me leje të posaçme të cilën e lëshon DSHP-ke.

DSHP-ke mund të caktoj edhe zona tjera të qytetit si zona të mbrojtura për këmbësorë.

#### **Neni 6.**

Në rrugët, në të cilat komunikacioni ndalohet në të dy drejtimet për të gjitha ose për disa lloje të automjeteve, mund të qarkullojnë: Automjetet e KFOR-it, UNMIK-ut, SHPK-ës, Zjarrfikësve, dhe të Ndiemes së shpejtë. Ndërsa për qarkullimin e automjeteve të tjera sipas nevojës ( të ndërmarrjeve publike dhe private) si dhe banorëve të këtyre rrugëve, do tu lëshohet leja përkatëse për kohë dhe orar të caktuar nga ana e Drejtorisë për Shërbime Publike.

#### **Neni 7.**

Automjetet të cilat kryejn transportin e materialeve të rrezikshme nuk mund të ndalen në rajonin e qytetit dhe të vendbanimeve.

### **4. Ndalja dhe parkimi**

#### **Neni 8.**

Në disa rrugë ose pjesë të rrugëve dhe vendeve mund të kufizohet ose të ndalohet parkimi dhe ndalja e automjeteve vetëm atëherë kur e kërkojnë shkaqet e sigurisë së komunikacionit si dhe shkaqet e rendit dhe të qetësisë publike.

Përgjashtësisht, ndalja dhe parkimi i automjeteve mund të ndalohet dhe të kufizohet edhe kur ate e kërkojnë shkaqet e mbrojtjes së kushteve të mjedisit jetësor, sipërfaqet e gjelbruara dhe të mirëmbajtjes së pastërtisë, sipas kërkesës së organit kompetent për këtë qëllim, për çka DSHP do të marrë vendim të posaçëm.

#### **Neni 9.**

Në rajonin e ngushtë të qytetit ndalohet parkimi i autobusëve, i mjeteve të transportit dhe mjeteve të specializuara të transportit mbi 2 tona të peshës së

përgjithshme, mjeteve tërheqëse dhe makinave të punës, përveç në vendet posaqërisht të caktuara për këtë qëllim nga ana e DSHP-ke.

#### **Neni 10.**

Në rrugë, trotuare, sheshe dhe në sipërfaqet tjera të komunikacionit ndalohet pastrimi dhe riparimi i automjeteve.

Në rrugë, trotuare, sheshe dhe në sipërfaqet tjera të komunikacionit ndalohet lënja e automjeteve për pritje për riparim. Ato mund të vendosen për pritje për riparim vetëm brenda hapsirave të punëtorëve të dedikuara për këtë qëllim.

#### **Neni 11.**

Vendparkimet, në vështrim të këtij vendimi, janë sipërfaqet e komunikacionit publik në të cilin mund të parkohen automjetet motorrike dhe mjetet tjera më gjatë se 15 minuta

Vendparkime mund të jenë: vendparkimet e përgjithshme dhe sipërfaqet e rezervuara për parkim.

#### **Neni 12.**

Vendparkimet e përgjithshme janë vendet në të cilat mund të parkohen automjetet në të cilat vende, nuk janë të ndaluara me shenja dhe rregulla të komunikacionit.

#### **Neni 13.**

Sipërfaqet e rezervuara për parkimin e automjeteve duhet të jenë të shënuara me shenjen përkatëse të komunikacionit, vend ky i rregulluar dhe sipas nevojës i siguruar, për të cilin DSHP-ke vendos dhe lëshon leje për rezervimin e sipërfaqes.

Shenimi, rregullimi dhe sigurimi i sipërfaqes së rezervuar për parkimin e automjeteve bije në barrë të shfrytëzuesit të asaj sipërfaqeje.

#### **Neni 14.**

Automjetet e parkuara në sipërfaqen e rezervuar për parkim doemos duhet të jenë veçmas të shënuara sipas mënyres së përcaktuar nga DSHP-ke.

#### **Neni 15.**

Në trotuar ndalohet parkimi i automjeteve.

Përrjashtimisht parkimi i automjeteve në trotuar mund të lejohet vetëm nëse gjërsija e trotuarit mundson që pranë automjeteve të parkuara të mbetet kalim i lirë për këmbësorë së paku edhe 1,5 m. dhe nëse trotuari është i shënuar dhe rregulluar posaqërisht për parkimin e automjeteve.

Në trotuar ndalohet parkimi i automjeteve të transportit, automjeteve të specializuara të transportit, autobusëve si dhe automjeteve të udhëtarëve me kamprimorkio.

#### **Neni 16.**

Në vendet në të cilat është e ndaluar ndalja dhe parkimi mund të ndalen vetem automjetet e cekura në nenin 6 të kësaj rregullorje dhe mjetet me leje të posaçme të lëshuar nga DSHP-ke.

#### **Neni 17.**

Në qoftë se personi – zyrtar i autorizuar i cili ushtron mbikëqyrjen dhe bënë rregullimin e komunikacionit, has në automjetin e parkuar në vendin në të cilin ai paraqet rrezik të drejtëpërdrejt ose pengesë të posaçme për komunikacion do të urdhërojë që automjeti të largohet me konfiskimin e përkohshëm prej rrugës apo trotuarit, në shpenzimet e pronarit, gjegjësisht të shfrytëzuesit.

#### **Neni 18.**

Në vendet e caktuara me shenjen e për parkim, në vendparkimet e përgjithshme paguhet kompenzimi për parkim.

Lartësin e kompenzimit, kohën dhe kushtet e parkimit e cakton DSHP-ke.

#### **Neni 19.**

Pronarët, respektivisht drejtuesit e automjeteve të parkuara në vendparkingjet e caktuara me kompensim, mund të dalin nga parkingu vetëm pasi t'i kenë paguar shërbimet e parkingut.

#### **Neni 20.**

Në vendparkimet e përgjithshme mund të kufizohet përkohësisht parkimi i automjeteve.

Koha për të cilën është lejuar parkimi i automjeteve domosdo duhet të shenohet me shenjë të komunikacionit, pronari-drejtuesi i automjetit ka për detyrë ta heqë automjetin pas kalimit të asaj kohe.

#### **Neni 21.**

Nëse personi i autorizuar për rregullimin e komunikacionit has në mjetet e parkuara në vendet ku parkimi është i kufizuar pas kalimit të kohës së lejuar për parkim, mund të urdhërojë heqjen e mjetit nga ai vend me shpenzime të pronarit ose të shfrytëzuesit të automjetit.

#### **Neni 22.**

Në sipërfaqet publike në të cilat është i kufizuar parkimi i automjeteve, nuk mund të parkohen automjetet e prishura, ose të havarisura apo rimorkiot e tyre.

#### **Neni 23.**

Në vendet në të cilat, koha e parkimit, nuk është i kufizuar parkimi i automjeteve, ndalohet më gjatë se 24 orë lënja e automjetit të prishur ose të avarisur.

Nëse personi i autorizuar zyrtar i cili ushtron kontrollin e komunikacionit gjen në sipërfaqet e komunikacionit publik të parkuar atomjetin e prishur, të avarisur ose të braktisur, do të urdhëroj që automjeti i tillë të hiqet në shpenzimet e pronarit të tij, gjegjësisht të shfrytëzuesit dhe të vendoset në vend të caktuar.

Në rast se nuk dihet pronari i automjetit të braktisur, shpenzimet e heqjes nga sipërfaqet publike do t'i bartë komuna.

#### **Neni 24.**

Automjetet të cilat me urdhëresen e personave të autorizuar hiqen nga sipërfaqet publike dhe vendosen në vendin e caktuar, pronarët e tyre mund ti tërhiqin pasi t'i kenë paguar shpenzimet e tërheqjes, kompanisë bartëse dhe shpenzimet e qëndrimit në vendin e caktuar sipas tarifave në të cilat ka dhënë pëlqimin e DSHP-ke.

#### **Neni 25.**

Personat e autorizuar zyrtar mund t'i thirrin për tërheqjen e mjeteve vetëm ato kompani të cilat kanë marrëveshje ose kontratë me komunën.

### **5. Stacionet dhe vendet e ndaljes për automjetet me të cilat bëhet transporti Publik dhe transporti tjetër i udhëtarëve dhe në grupe**

#### **Neni 26.**

Automjetet taksi me të cilat kryhet transporti i udhëtarëve mund të parkohen në vendet të cilat posaçërisht për to janë të rregulluara dhe të shënuara.

#### **Neni 27.**

Në vendet e caktuara nga neni 26 ndalohet ndalja dhe parkimi i automjeteve tjera.

### **6. Qarkullimi i bicikletave, biçikletave me motor dhe motoçikletave**

#### **Neni 28.**

Ndalohet drejtimi i biçikletave, biçikletave me motor dhe motoçikletave në trotuare, parqe, vendgjelbrime dhe zonat e mbrojtura të qytetit të Vushtrrisë.

## **III. MASAT E VEÇANTA PËR SIGURIMIN E KOMUNIKACIONIT**

#### **Neni 29.**

Ndalohet dhënja e panderprerë e sirenës pa shkaqe të arsyeshme dhe kur atë nuk e kërkojnë shkaqet e sigurimit të komunikacionit.

#### **Neni 30.**

Për vënjen e shenjave të komunikacionit, shenjave në rrugë si dhe pajimet për rregullimin e komunikacionit kujdeset DSHP-ke.

#### **Neni 31.**

Ndalohet vendosja, heqja apo dëmtimi i shenjave të komunikacionit dhe shenjave tjera në rrugë pa autorizimin e DSHP-ke.

#### **Neni 32.**

Për mirëmbajtjen e shenjave të komunikacionit kujdeset DSHP-ke dhe për këtë mund të lidhë kontratë apo marrëveshje me ndonjë person juridik apo fizik.

Kontrata apo marrëveshja duhet të jetë me afat të caktuar, por afati i saj nuk mund të jetë me gjatë se një vit. Pas skadimit të afatit mund të lidhet kontratë e re.

### **Neni 33.**

Në udhëkryqet ose këndet e rrugëve në trekëndëshin e shikimit si dhe në kthesa, nuk është e lejueshme vendosja e çfardo objekti, panoje, reklame dhe bimësh të cilat me madhësinë e vet do të zvogëlonin të pamurit në komunikacion.

### **Neni 34.**

Në rrugë, trotuare, sheshe dhe në sipërfaqet tjera të komunikacionit nuk mund të vendosen pengesa si: barriera, kontenjer, sakti betoni, shtylla etj.

### **Neni 35.**

Në rrugët nëpër të cilat zhvillohet komunikacioni, trotuare apo sipërfaqe tjera publike ku mund të pengohet komunikacioni ndalohet vendosja e objekteve të ndryshme si: shtylla elektrike, trafove, shtyllave të telefonit etj. Si dhe çfardo pengese tjetër që do të pengonte zhvillimin normal të komunikacionit.

Për të gjitha pengesat egzistuese si janë shtyllat elektrike të telefonit etj. inspektori i komunikacionit mund tu urdhërojë shfrytëzuesëve të objektve të tilla me aktvendim heqjen ose zhvendosjen e tyre në afatin e caktuar sipas aktvendimit, i cili afat është 8 deri 30 ditë.

### **Neni 36.**

Ndalohet zënja e trotuareve dhe sipërfaqeve tjera publike të komunikacionit me pengesa të ndryshme nga ana e personave juridik dhe fizik.

Në raste të veqanta troruaret dhe sipërfaqet tjera të komunikacionit me lejen e DSHP-ke mund të shfrytëzohen përkohësisht për nevojat e personave juridik dhe fizik.

### **Neni 37.**

Ndalohet shitja e automjeteve, gjegjësisht ekspozimi i automjeteve për shitje në rrugë, trotuare dhe në skfere, në teritorin e qytetit.

### **Neni 38.**

Ndalohet shitja e pemëve, perimeve, prodhimeve tjera bujqësore si dhe çfardo shitje tjetër në rrugë, për rreth rrugëve të komunikacionit dhe në trotuare.

### **Neni 39.**

Ndalohet hedhja e mbeturinave dhe materialeve tjera në rrugë, rreth rrugëve, trotuare dhe në sipërfaqe të tjera të komunikacionit.

## **IV. DISPOZITAT NDESHKIMORE**

### **Neni 40.**

1. prej 25 € gjerë 100 €, gjobitet personi përgjegjës ose peroni juridik për kundërvajtjen e bërë nga dispozitat e nenit 5 dhe 6 të kësaj Rregullorje.

2. prej 25 € gjerë 100 €, gjobitet personi përgjegjës ose personi tjetër juridik për kundërvajtjen e bërë nga dispozitat e nenit 10 të kësaj Rregullorje.

3. prej 25 € gjerë 250 €, gjobitet personi përgjegjës ose personi tjetër juridik për kundërvajtjen e bërë nga dispozitat e nenit 24 të kësaj Rregullorje.

4. prej 25 € gjerë 100 €, gjobitet personi përgjegjës ose personi tjetër juridik për kundërvajtjen e bërë nga dispozitat e nenit 27 të kësaj Rregullorje.

5. prej 25 € gjerë 500 €, gjobitet personi përgjegjës ose personi tjetër juridik për kundërvajtjen e bërë nga dispozitat e nenit 31 të këtij Vendimi

6. prej 25 € gjerë 100 €, gjobitet personi përgjegjës ose personi tjetër juridik për kundërvajtjen e bërë nga dispozitat e nenit 33 të kësaj Rregullorje.

7. prej 25 € gjerë 250 €, gjobitet personi përgjegjës ose personi tjetër juridik për kundërvajtjen e bërë nga dispozitat e nenit 34 të kësaj Rregullorje.

8. prej 150 € gjerë 500 €, gjobitet personi përgjegjës ose personi tjetër juridik për kundërvajtjen e bërë nga dispozitat e nenit 35 të kësaj Rregullorje.

9. prej 25 € gjerë 150 €, gjobitet personi përgjegjës ose personi tjetër juridik për kundërvajtjen e bërë nga dispozitat e nenit 36 të kësaj Rregullorje.

10. prej 10 € gjerë 100 €, gjobitet personi përgjegjës ose personi tjetër juridik për kundërvajtjen e bërë nga dispozitat e nenit 37 të kësaj Rregullorje.

11. prej 50 € gjerë 400 €, gjobitet personi përgjegjës ose personi tjetër juridik për kundërvajtjen e bërë nga dispozitat e nenit 39 të kësaj Rregullorje.

#### **Neni 41.**

Personi i autorizuar zyrtar nga neni 42 i kësaj Rregullorje, mund të shqiptoj denim mandator prej 35 €, për kundërvajtje nga neni 19 dhe 28 i kësaj Rregullorje, ndërsa për kundërvajtje nga neni 38 i kësaj Rregullorje mund të shqiptoj denim mandator prej 20 €.

### **V. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 42.**

Për zbatimin e kësaj Rregullorje do të kujdesen: Inspektori i komunikacionit, Inspektori i rrugëve, Policija e trafikut dhe Inspektorët tjerë komunal, secili prej tyre në kuadër të kompetencave të veta.

#### **Neni 43.**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit në Kuvendin Komunal.



Kryetari i Kuvendit Komunal.

  
**Muharrem Shabani**